

NEWSLETTER

Korrik

MARTIN ALBANIA GARRIX

Luaj Online me Albsig dhe fito bileta falas për koncertin e Martin Garrix.

Analiza 7 mujore e punës në Albsig: Performanca e suksesshme finaciare, reduktim i kostove dhe zgjidhja e shpejtë e kërkesave të klientëve. Albsig shpërblen punonjësit.

Albsig mbështet trupën e Portokallisë në Serialin e Verës, “Verë dhe Portokalle”.

Në prag të vitit të ri shkollor Albsig iu bën apel prindërve për sigurimin e nxënësve gjatë periudhës së shkollës. Pajisni nxënësit dhe studentët me sigurimin e duhur në Albsig.



ALBSIG

PJESË E  KASTRATI GROUP

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP



Luaj Online me Albsig dhe fito bileta falas për koncertin e Martin Garrix.

Kompania e sigurimeve Albsig ka organizuar një lojë online për t'ju ofruar mundësinë fituesve të saj të marrin biletat për koncertin e Dj të famshëm Martin Garrix. Kjo lojë u ideua dhe u krijua për të angazhuar klientët dhe për të promovuar shërbimet e Albsig. Mjaftonte të ndiqnin Albsigun në rrjetet sociale dhe të zbatonin rregullat e prezantuara të lojës online dhe mund të fitonin biletat për të parë më nga afër koncertin e Martin Garrix. Jo vetëm kaq, por tashmë dihet se Albsig ka qenë gjithmonë në krah të fituesve. Pas procedurave të ndjekura, u shpallën fituesit e lojës online për koncertin e Martin Garrix në Tiranë! Albsig njoftoi fituesit e lojës online që ofroi mundësinë për të fituar biletat për koncertin. Për të gjithë adhuruesit e muzikës elektronike dhe lojtarët e zjarrtë të lojërave online, ky ishte momenti i tyre më i artë! Albsig, kompania e njohur e sigurimeve, nisi një "minidhuratë online" emocionuese që na solli më pranë se kurrë artistit tonë të preferuar.

Merr pjesë në lojë dhe luaj së bashku me familjarët.

Pjesëmarrja në lojë duhej të regjistrohej në platformën online të Albsig dhe të plotësoheshin disa detyra të thjeshta, si psh: **share** i albsig në rrjetet sociale dhe **tag** shokët dhe miqtë më të afërt, si dhe **follow** faqet e www.albsig.al, www.albsig-jetë.al dhe www.albsiginvest.al. Ky angazhim u bë për të promovuar shërbimet e Albsig, dhe jo vetëm kaq. Me disa hapa të thjeshtë të udhëzimeve të lojës, konsumatorëve ju ofrua një mundësi unike për të fituar biletat për një nga ngjarjet më të mëdha muzikore të vitit të realizuara në metropolin shqiptar.

Fituesit dhe shpërblimi tyre i menjëhershëm.

Fituesit e lojës u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme dhe u njoftuan menjëherë përmes emailit zyrtar dhe rrjeteve sociale të shoqërisë së sigurimeve Albsig. Çdo fitues mori biletat për koncertin e Martin Garrix, i cili u mbajt në një nga sheshet më të veçanta dhe të njohur për fansat e muzikës elektronike.

Koncerti i Martin Garrix.

Martin Garrix është një ndër DJ më të njohur në botë dhe koncertet e tij tërheqin mijëra fansa. Albsig, duke ofruar këto bileta synoi të krijojë një eksperiencë të paharrueshme për klientët e saj duke i shpërblyer ato për besnikërinë dhe angazhimin e tyre.

Për një informacion më të detajuar mbi lojën dhe mbi produktet e sigurimeve të domosdoshme për ju dhe familjen tuaj vizitoni faqen e albsig www.albsig.al dhe merrni në kohë rekord shërbimet dhe ofertat për produktet që ju duhen.







Analiza 7-mujore e punës në Albsig: Performanca e suksesshme finaciare, reduktim i kostove dhe zgjidhja e shpejtë e kërkesave të klientëve. Albsig shpërblen punonjësit.

Muaji që lamë pas ka qenë një periudhë e suksesshme për Kompaninë e Sigurimeve Albsig. Sh.a.. Pas një analize të detajuar të punës për shtatëmuorin e parë të këtij viti, rezultatet janë tejet pozitive dhe shumë të suksesshme në të gjitha aspektet kyçe të shoqërisë. Në një raport të përmbledhur të analizave të detajuara të performancave mujore, iu ofrua stafit një vështrim i detajuar mbi arritjet e çdo muaji përmbledhur dhe në 7-mujorin e parë të këtij viti si dhe sfidat e kapërcyera dhe strategjitë që do të vazhdojnë të çojnë përpara Albsig-un. Jo vetëm kaq, por performanca operacionale gjithashtu thuhet se ka qenë e shkëlqyer, me një përmirësim të ndjeshëm në shërbimet ndaj klientit dhe një ulje të ndjeshme të kohës së përgjigjeve për kërkesat e klientëve. Këto përmirësime duket se kanë reflektuar në angazhimet e Albsig për të siguruar një përvojë të jashtëzakonshme me çdo klient.



Performanca financiare.

Duket se të gjitha bilancet mujore të përmbledhura nën shifrën e përgjithshme të punës së shtatëmuorit të parë të këtij viti kanë ardhur në rritje për një numër të konsiderueshëm produktesh. Këto arritje duket se kanë ardhur falë një kombinimi të politikave të mira të marketingut, një shërbimi cilësorë ndaj klientit dhe zgjerimit të bazës së klientëve.



Reduktimi i kostove.

Rezultatet pozitive në shumë produkte e shërbime të Albsig duket se kanë arritur të reduktojnë edhe kostot operacionale. Përmirësimet në proceset e brendshme dhe përdorimi me efikas i teknologjisë kanë kontribuar në këtë ulje të kostove duke e bërë operacionin tonë më të qëndrueshëm financiarisht.



Performanca e shërbimit ndaj klientëve.

Një tjetër sukses i rëndësishëm ka qenë përmirësimi i kënaqësisë së klientëve. Anketat e fundit tregojnë një rritje të konsiderueshme të niveleve të kënaqësisë falë reagimit të shpejtë dhe profesional ndaj kërkesave dhe pretendimeve të klientëve.



Angazhimet ndaj Përgjegjësisë Sociale dhe Projekteve në Komunitet.

Përtej performancës financiare dhe operacionale, Albsig ka vijuar të jetë një aktor aktiv në komunitetin ku ajo përfaqëson. Gjatë këtyre muajve, Albsig ka dhënë mbështetjen e saj në disa iniciativa të rëndësishme sociale dhe projekte që kanë sjellë përfitime të drejtëpërdrejta për komunitetin. Ky angazhim për përgjegjësinë sociale është një nga shtyllat e filozofisë së Albsig dhe kompania do të vazhdojë të kontribuojë në mënyrë aktive në përmirësimin e jetës së çdo qytetari.



Sfidat dhe perspektivat e reja të Albsig.

Ndërsa analizojmë rezultatet pozitive të arritura deri tani, jemi të vetëdijshëm se çdo sukses vjen me sfidat e tij. Albsig, gjatë kësaj periudhe është përballur me disa sfida të rëndësishme, të cilat e kanë ndihmuar të rritet dhe të përmirësohet në të gjitha proceset e saj. Duke bërë përpara, Albsig është përshtatur të vazhdojë këtë rrugë të rritjes dhe zhvillimit, duke përqendruar përpjekjet tona në përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve dhe produkteve të saj, si dhe në zgjerimin e pranisë së saj në treg. Analiza 7-mujore e punës në Albsig na ka dhënë një pasqyrë të qartë të progresit që kemi bërë dhe të mundësive që qëndrojnë përpara.



Zgjidhja e shpejtë e kërkesave.

Procesi i zgjidhjes së kërkesave ka qenë gjithashtu një aspekt ku duket se është bërë një përmirësim i dukshëm në çdo muaj duke u kurorëzuar në përmbledhjen e gjashtëmujorit të parë të këtij viti. Vetëm falë punës së përkushtuar koha mesatare për zgjidhjen e kërkesave është reduktuar me 20% duke u bërë më të shpejtë dhe më efikas në përmbushjen e detyrimeve ndaj klientëve.



Shpërblimi i punonjësve.

Në Albsig, besojmë se sukcesi i kompanisë është i lidhur ngushtë me përkushtimin dhe angazhimin e punonjësve të saj. Për të motivuar dhe për të inkurajuar një mjedis pune të orientuar drejt rezultateve, Albsig ka krijuar një mundësi shpërblimi që synon të njohë kontributet e veçanta të gjithsecilit nga punonjësit. Gjatë kësaj periudhe, disa nga ekipet dhe individët që kanë shënuar rezultate të jashtëzakonshme janë shpërblyer me bonuse dhe përfitime të tjera. Kjo metodë shpërblyese ndaj punonjësve është një reflektim dhe përkushtim për të vlerësuar ata që kontribuojnë në suksesin e përgjithshëm të kompanisë. Përtej shpërblimeve financiare, Albsig vazhdon të investojë në përmirësimin e kulturës së punës dhe në krijimin e një ambienti mbështetës për të gjithë. Albsig synon të ofrojë mundësi të vazhdueshme për zhvillimin profesional, duke siguruar që çdo punonjës të ndihet i vlerësuar dhe i motivuar për të dhënë më të mirën. Kjo mënyrë shpërblimi është vetëm një nga mënyrat se si shpreh mirënjohjen Albsig për punonjësit që japin kontributin më të madh në arritjen e objektivave të përbashkëta. Në Albsig, besojmë se punonjësit tanë janë aset i rëndësishëm dhe sukcesi i tyre është sukcesi ynë. Duke njohur dhe shpërblyer performancën e tyre të lartë, ne jemi të bindur se do të vazhdojmë të rrisim standardet tona të ekselencës dhe të ndërtojmë një të ardhme të qëndrueshme dhe të suksesshme për të gjithë.

Angazhimet ndaj Përgjegjësisë Sociale dhe Projekteve në Komunitet.

Përtej performancës financiare dhe operacionale, Albsig ka vijuar të jetë një aktor aktiv në komunitetin ku ajo përfaqëson. Gjatë këtyre muajve, Albsig ka dhënë mbështetjen e saj në disa iniciativa të rëndësishme sociale dhe projekte që kanë sjellë përfitime të drejtëpërdrejta për komunitetin. Ky angazhim për përgjegjësinë sociale është një nga shtyllat e filozofisë së Albsig dhe kompania do të vazhdojë të kontribuojë në mënyrë aktive në përmirësimin e jetës së çdo qytetari.

Sfidat dhe perspektivat e reja të Albsig.

Ndërsa analizojmë rezultatet pozitive të arritura deri tani, jemi të vetëdijshëm se çdo sukses vjen me sfidat e tij. Albsig, gjatë kësaj periudhe është përballur me disa sfida të rëndësishme, të cilat e kanë ndihmuar të rritet dhe të përmirësohet në të gjitha proceset e saj. Duke bërë përpara, Albsig është përshtatur të vazhdojë këtë rrugë të rritjes dhe zhvillimit, duke përqendruar përpjekjet tona në përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve dhe produkteve të saj, si dhe në zgjerimin e pranisë sa më të madhe të saj në treg. Analiza 7-mujore e punës në Albsig na ka dhënë një pasqyrë të qartë të progresit që kemi bërë dhe të mundësive që qëndrojnë përpara.






Albsig mbështet trupën e Portokallisë në Serialin e Verës, “Verë dhe Portokalle”.

Kompania e Sigurimeve Albsig ka mbështetur trupën e njohur të humorit “Portokalli” në kuadër të serialit të tyre të verës, “Verë dhe Portokalle”. Ky bashkëpunim vjen si përpjekje për të promovuar artin dhe kulturën shqiptare duke sjellë humor dhe argëtim në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Spektakli “Verë dhe Portokalle” është një iniciativë e njohur e spektaklit “Portokalli”, që përfshin performanca humoristike dhe artistike në sheshet e qyteteve të ndryshme.

Këtë vit ndalesa e trupës së portokallisë ka përfshirë dhe **Hamallajn**, ku publiku i gjithë rrethinave të qytetit të Durrësit ka ndjekur nga afër artistët e tyre të preferuar. Aktorët e humorit duket se nuk kanë bërë asnjë ditë pushim këtë verë por i janë përkushtuar spektatorit duke u falur artdashësve të humorit një spektakël të veçantë. “Verë dhe Portokalle” u ndal edhe në Hamallaj për t’i falur humorin dhe një natë plot emocione publikut që e priti me duartrokitje spektaklin. Ndryshe nga herët e tjera, kjo puntatë spektakli ndër më të kërkuarit dhe më të shikuarit i humorit shqiptar, u mbështet nga Albsig, pjesë e Kastrati group.

Albsig, një ndër kompanitë më të suksesshme të sigurimeve në Shqipëri, ka mbështetur me sponsorizim puntatën e radhës së spektaklit të humorit “Portokalli” në kuadër të serialit të verës “Verë dhe Portokalle”. Këto seriale janë zhvilluar tashmë në qytete të ndryshme të Shqipërisë, si Korça Policani, Gramshi, Kamza, Hamallaj e shumë qytete të tjera. Në sheshet kryesore spektakli i humorit mbledhi publikun vendas për të shijuar humorin dhe performancat e aktorëve të tyre të preferuar. Si çdo vit, turi i “Verë dhe Portokalle” mbledhi në sheshe qytetarë të shumtë që prisnin me padurim të shijonin nga afër humorin, performancat e artistëve dhe gjithçka ky spektakël dhuroi. Në këtë takim të artistëve me publikun Hamallaj që ndryshe nga çdo fundjavë e vitit, nuk zhvillohej përmes ekranit por në një skenë të vendosur në qendër të qytetezës e ku sytë e publikut ndoqën me kërshtëri çdo moment, emocionet e artistëve janë të shumëfishta.

Pas Hamallaj, spektakli Verë dhe Portokalle që shënon një prej eventeve më të bukura verore, do të ndalej në Kukës. Albsig mbështeti këtë nismë duke synuar të promovojë jo vetëm markën e saj, por edhe të kontribuojë në zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike në Shqipëri. Ky bashkëpunim reflektoi në angazhimin e kompanisë për të mbështetur eventet që bashkojnë komunitetin dhe nxisin atmosferë pozitive dhe të gjallë në vend.



Albsig mbështet financiarisht shfaqjen “Verë e Portokalle” në Kukës.



Verë dhe Portokalle zbriti në destinacionin e rradhës në qytetin verior të Kukësit.

Shfaqja e humorit Verë e Portokalle, mbështetur nga Albsig, udhëtoi në qytetin e Kukësit. Në sheshin qendror në qytetin e Kukësit është zhvilluar dhe portokallia e radhës. Të gjithë artëdashësit janë shpërngulur në sheshin e qytetit për të parë më nga afër artistët e tyre të preferuar të humorit dhe jo vetëm. Ky lloj aktiviteti është pjesë e një turneu shfaqjesh, ku ajo prezantohet në qytetet e ndryshme të shqipërisë, duke sjellë argëtim për të gjithë komunitetin e zonës.

Aktorët që çdo të dielë mbajnë para ekranit publikun shqiptar, tashmë po i takojnë ata nga afër qytet pas qyteti. Pjesëmarrja masive ka qenë e dukshme, me të qeshura dhe emocione dhe humorin e papërsëritshëm të “Portokalli”. Çdo numër është përgatitur nga fillimi për t’ju përshtatur motos “Verë dhe Portokalle”. Turneu do të vijojë deri më 15 gusht. Mbështetja financiare e Portokallisë nga Albsig shpreh gjithmonë gatishmërinë dhe përhapjen e këtyre ngjarjeve kulturore në zonat më të skajshme të vendit.





Në prag të vitit të ri shkollor Albsig iu bën apel prindërve për sigurimin e nxënësve gjatë periudhës së shkollës.

Ja pse duhet të pajisni nxënësit dhe studentët me sigurimin e duhur në Albsig.

Edhe pothuajse 30 dite kanë mbetur nga fillimi i vitit të ri shkollor 2024-2025. Përveç përgatitjeve për artikujt shkollorë dhe librat, prindërit duhet të pajisin fëmijët e tyre dhe me sigurimin e nxënësve. Albsig ka bërë një apel drejtuar prindërve që të konsiderojnë sigurimin e fëmijëve të tyre, veçanërisht nxënësve, si një masë e rëndësishme për t'i mbrojtur ata nga rreziqet që mund të ndodhin gjatë periudhës së shkollimit. Ky apel vjen si një mënyrë për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e sigurimit të nxënësve dhe për t'u ofruar atyre mbrojtje financiare për familjet e tyre në rast aksidentesh apo emergjencash të ndryshme.

Apeli i Albsig fokusohet në shtyllat kryesore që i vijnë në ndihmë çdo familje me fëmijë në shkollë

Pajisja me sigurim e fëmijëve është mënyra më e mirë e cila bën të mundur në mënyrë të menjëherëshme sigurinë e fëmijëve tuaj në çdo kohë. Duke siguruar fëmijët e tyre prindërit kontribuojnë në një mjedis më të sigurtë për ta, duke pasur garancinë se ata marrin kujdesin e nevojshëm në rast të ndodhjes së ngjarjeve të papritura në shkollë dhe jashtë saj. Sigurimi nga aksidentet i nxënësve dhe studentëve është një masë e rëndësishme që mund të ofrojë mbrojtje dhe qetësi për prindërit, shkollat dhe vetë nxënësit.

Nxënësit dhe studentët janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme gjatë kohës që janë në shkollë dhe në rrugë për në shkollë ose/dhe gjatë aktiviteteve jashtëshkollore. Një sigurim nga aksidentet mund të mbulojë shpenzimet mjekësore në rast të aksidenteve duke lehtësuar barrën financiare mbi prindërit dhe buxhetin familjar.

Siguri fizike dhe mbrojtje financiare

Mbrojtje të aktiviteteve jashtëshkollore

Shumë shkolla organizojnë aktivitete jashtëshkollore si ekskursionë, sporte apo kampe verore, të cilat kanë një nivel më të lartë rreziku. Sigurimi nga aksidentet do të mbulojë edhe këto raste duke i siguruar nxënësit dhe studentët të marrin kujdesin e nevojshëm pa ju shtuar dozën e madhe të stresit prindërve.

Në disa vende sigurimi nga aksidentet është i detyrueshëm për nxënësit. Pajisja e nxënësve me sigurim të tillë mund të mbrojë shkollën, prindërit edhe nga ndonjë përgjegjësi ligjore në rast aksidenti.

Mbrojtje Ligjore

Kujdes shëndetësor i shpejtë dhe i kualifikuar

Nëse ndodh një aksident nxënësit që janë të pajisur me sigurim të tillë mund të marrin trajtimin e duhur shëndetësor dhe shumë efikas në mënyrë të shpejtë, duke minimizuar rreziqet e komplikimeve të mëtejshme.

Sigurimi nga aksidentet ofron një shtesë të shtuar mbrojtjeje që u jep prindërve dhe shkollave paqe mendore dhe stabilitet të garantuar duke ditur se fëmijët janë të mbrojtur edhe në rast të papriturash. Pajisja e nxënësve dhe studentëve me sigurimin e aksidenteve nuk është një masë mbrojtëse por është edhe një investim për shëndetin dhe sigurinë e tyre përgjatë periudhës së shkollës dhe jo vetëm. Duke pasur një sigurim të tillë nxënësit dhe familjet e tyre do të ndihen edhe më të sigurtë dhe më të mbrojtur ndaj rreziqeve të mundshme që mund të ndodhin gjatë përvojave shkollore dhe jo vetëm.

Lehtësim financiar për prindërit dhe shkollat



ALBSIG

PJESË E



KASTRATI GROUP



 +355 (0) 42254770 / 764

 info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL